

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve Xh. Xh., B. A. dhe B. Xh., për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 pika 11 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK, si dhe secili veç e veç për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve Xh. Xh. dhe B. Xh., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 507/2013 datë 17.12.2014 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 219/2015 datë 14.07.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve Xh. Xh. dhe B. Xh., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 507/2013 datë 17.12.2014 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 219/2015 datë 14.07.2015.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 507/2013 datë 17.12.2014, të dënuarit Xh. Xh., B. A. dhe B. Xh. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK dhe dy vepra penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK, të ndëshkuara sipas nenit 147 par. 11 të KPK dhe secili veç e veç edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK dhe për këto vepra penale i dënuari Xh. Xh. është gjykuar me dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 22 (njëzetedy) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim që nga data 21.09.2008 e tutje, ndërsa të dënuarve B. A. dhe B. Xh., pasi që iu kanë përcaktuar dënimet për secilën vepër veç e veç janë gjykuar B. A. me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.09.2008 e tutje ndërsa B. Xh. me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 03.10.2008 e tutje. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues marrja e pushkës automatike nga i dënuari Xh. Xh. AK-47 me numër serik 4216090. Janë detyruar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumë prej nga 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit F. M., A. M. dhe L. K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr. 219/2015 datë 14.07.2015, si në vijim:

“I.Me rastin e ankesave të Prokurorisë Themelore Prishtinë dhe mbrojtësve të të akuzuarve Xh. Xh., B. A. dhe B. Xh., e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, Pn.nr. 507/2013 datë 17.12.2014, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale ashtu që Gjykata e Apelit gjen se në veprimet e të

akuzuarve: Xh. Xh., B. A. dhe B. Xh. të përshkruara si në pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 nën.par. 11 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore Prishtinë dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Xh. Xh. B. A. dhe B. Xh., refuzohen si të pabazuara”.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur mbrojtësi i të dënuari Xh. Xh., H. L., avokat nga Prishtina dhe mbrojtësi i të dënuarit B. Xh., N. Sh., avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesat të aprovohen aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr. 49/2016 datë 21.03.2016, ka propozuar që kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Në kërkesën e tyre mbrojtësit të të dënuarve Xh. Xh. dhe B. Xh. në mënyrë identike theksojnë se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 të KPPK, të cilat shkelje konsistojnë në atë se të dy aktgjykimet bazohen në faktet irelevante e jo në ato relevante, dispozitivat e aktgjykimeve të kundërshtuara janë të pakuptueshëm, kundërthënës me arsyetimin, në arsyetimet e tyre nuk janë dhënë arsye lidhur me faktet vendimtare, kurse ato të paraqitura janë tërësisht të paqarta.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e lartcekura meqë këto pretendime janë stereotipe (parafrazimi i dispozitave ligjore) të pa përcjella me arsyetim meqë fare nuk janë dhënë arsye se në çfarë manifestohen këto shkelje.

Megjithatë kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka paqartësi në dispozitiv dhe në arsyetim, të dy aktgjykimet janë të qarta, në të janë dhënë arsye të qarta përkitazi me rrjedhën e ngjarjes, prezencën e të dënuarit B. në vendin e ngjarjes, motivin dhe dashjen e të dënuarve Xh. dhe B. për të kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

Vlerësimi i provave të administruara është bërë në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 370 par. 7 të KPPK. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me këto pretendime të cilat janë potencuar edhe në ankesën kundër aktgjyimit të shkallës së parë, duke dhënë përgjigje në pretendimet në fjalë të cilat arsye si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë.

Pjesa tjetër e të dy kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal e cila shkelje sipas pretendimeve të mbrojtësi të të dënuarit Xh., konsiston në atë se i dënuari Xh. nuk ka pasur dashjen që të ndjerin dhe të dëmtuarit t'i privojë nga jeta, ndërsa mbrojtësi i të dënuarit B. thekson se me asnjë provë nuk është vërtetuar fakti se i dënuari B. ka qenë bashkezekutor i veprës penale meqë ai nuk ka qenë në vendin e ngjarjes, i përkasin gjendjes së fakteve gjë që me këtë mjet juridik nuk mund të jetë objekt vlerësimi.

Megjithatë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e lartpërmendura nuk e vënë në dyshim gjendjen e fakteve të vërtetuara dhe aplikimin e ligjit penal.

Në këtë çështje penale me asnjë provë të administruar nuk vihet në dyshim përgjegjësia penale të të dënuarve përkitazi me veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar. Përndryshe të dënuarit dhe mbrojtësit e tyre në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk kanë kontestuar zhvillimin e ngjarjes kritike mirëpo i pari mohon se dashja e të dënuarit Xh. nuk ishte vrasja e tani të ndjerit dhe dëshmitarëve ndërsa, mbrojtësi i të dënuarit B. konteston prezencën e tij në momentin kritik të vendit të ngjarjes dhe ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese.

Vlen të theksohet se në këtë çështje penale nuk kanë qenë kontestuese këto fakte:

Se raportet në mes të familjes së të dënuarve Xh. dhe B. dhe tani të ndjerit B. M. kanë qenë të acaruar, për shkak se motra e tyre H. Xh. ka qenë e martuar për tani të ndjerin B. ndërsa martesë e tyre është prishur pas një viti. Se në mes të këtyre familjeve kanë filluar negociatat lidhur me këto mosmarrëveshje me qëllim që motra e të dënuarve të kthehet në shtëpinë e tani të ndjerit mirëpo, familja e të dënuarve lidhur me kthimin e motrës së tyre ka kërkuar kompozim në të holla, të cilat sipas dëshmitarëve F. M. dhe Z. M. do të duhej të jepeshin të dënuarve ditën kritike pas iftarit ndërsa ngjarja ka ndodhur në të njëjtën ditë rreth orës 15:20 dy orë para Iftarit. Nuk është kontestues fakti se në fshatin .... komuna e Podujevës, ku tani i ndjeri B. së bashku me të dëmtuarit A. M. dhe L. K. ishin nisur në drejtim të Prishtinës me automjetin – kamionetën “Wolksfagen kombi” me targa ..... për të shitur dru. Në vendin kritik ndalohen nga të dënuarit Xh., B. dhe B. A. si dhe E., Q. dhe F. Xh., të cilët aktualisht ndodhen në arrati, të gjithë të armatosur i dënuari Xh. me pushkë automatike ndërsa të tjerët me revole të tipit të panjohur. Me të ndaluar nga i dënuari Xh. i njëjti i urdhëron që t’i ngrinin duart lartë dhe të zbresin nga kombi dhe menjëherë fillon me të shtëna nga pushka automatike në drejtim të automjetit. Me këtë rast janë shkrepur 17 plumba nga pushka automatike ndërsa nga pistoleta M-57 4 plumba, gëzhojat e të cilëve janë gjetur në vendin e ngjarjes. Po ashtu, nuk ka qenë kontestues fakti se me këtë rast në këtë ngjarje janë përdorur tre lloj armësh si dhe fakti se tani i ndjeri B., sipas raportit të autopsisë është privuar nga jeta nga predha që është gjetur në rrobat e tij nga personi që e ka përdorur revolen M-57 të cal. 7.62 mm, ndërsa të dëmtuarit A. M. dhe L. K. janë plagosur nga arma automatike e që nuk ka qenë kontestuese se armën në fjalë e ka pasur i dënuari Xh..

Vendimin e saj, lidhur me zhvillimin e ngjarjes kritike gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në radhë të parë nga deponimet e dëshmitarëve okularë të dëmtuarve L. K., A. M. dhe Z. M., dëshmitarëve F. M., H. Xh., në bazë të ekspertizës së ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. F. D., ekspertit të balistikës Prof. H. K., nga raporti i autopsisë për tani të ndjerin B. M. dhe ekspertizës forenzike të kryer në Zagreb më datë 25.05.2009, raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes të datë 01.04.2014 si

dhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga mbrojtja e të dënuarve.

Nga deponimi i dëshmitarit – të dëmtuarit L. K. e cila deklaratë ka qenë konsekuente gjatë gjithë fazave të procedurës rezulton se i dënuari Xh. e kishte pushkën automatike ndërsa të dënuarit B. dhe B. A. revole me ngjyrë të zezë e një gjë të tillë e ka pohuar edhe i dënuari B. I njëjti dëshmitar në mënyrë të padyshimtë e ka vërtetuar prezencën e të dënuarit B. në vendin e ngjarjes dhe ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese kurse nga ana tjetër prezencën e të dënuarit B. ka pohuar edhe i dënuari Xh. i cili në procedurën paraprake më datë 21.09.2008 ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ka qenë B. A. i cili ka pasur revole ngjyrë të zezë ndërsa B. Xh. ka qenë në vendin e ngjarjes i cili siç deklaron së bashku me Q. ia kanë bartur fishekët pra kjo deklaratë e cila përputhet me deklaratën e dëshmitarit – të dëmtuarit L. K. lidhur me prezencën e të dënuarit B. i cili ka mohuar prezencën e tij në vendin e ngjarjes. Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike, se raportet midis familjes së të dënuarve dhe tani të ndjerit, kanë qenë të çrregulluara si dhe fakti se të dënuarit ditën kritike nga prita e ndalojnë tani të ndjerin të gjithë të armatosur me ç'rast tani i ndjeri B. privohet nga jeta kurse të dëmtuarit A. M. dhe L. K. pësojnë lëndime të rënda trupore, dalin si të drejta konkludimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me zhvillimin e ngjarjes kritike, motivin dhe dashjen e të dënuarve për të kryer vepra penale.

Këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë lidhur me zhvillimin e ngjarjes dhe dashjen e të dënuarve për të kryer veprën penale e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë, për çfarë janë dhënë arsye të plota në faqet 5, 6, 7, 8 dhe 9 në veçanti vlerësimi i tezës së mbrojtjes të të dënuarve Xh. dhe B. Xh., si dhe arsye lidhur me ricilësimin e veprës penale, të cilat konkludime si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë, pra drejt është aplikuar ligji penal.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.75/2016, më 30 mars 2016

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit,  
Avdi Dinaj